

Emertimi dhe Forma ligjore:

“VIANTE Konstruksion” sh.p.k

NIPT –i:

K47103804L

Adresa e Selise:

Gramsh

Data e krijimit:

23.02.2005

Nr. I Regjistrit Tregtar

33037

Veprimtaria Kryesore:

Ndertim – Projektim, Rikonstruksione

PASQYRAT FINANCIARE

(Ne zbatim te Standartit Kombetar te Kontabilitetit Nr 2
dhe Ligjit Nr. 25/2018, date 10.05.2018 “Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”)

VITI 2021

Pasqyrat Financiare jane individuale
Pasqyrat Financiare jane te shprehura ne Lek
Pasqyrat Financiare nuk jane te rumbullakosura
Periudha Kontabel e Pasqyrave Financiare nga 01.01.2021-31.12.2021
Data e mbylljes se Pasqyrave Financiare 25.01.2022



Pasqyra e Pozicionit Financiar	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
AKTIVET		
Aktive afatshkurtra		
Mjete monetare	32,082,585	31,437,978
Investime		
<i>Ne tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
Te drejta te arketueshme		
<i>Nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	297,595,746	114,822,101
<i>Te tjera</i>	255,083	4,293,279
Inventaret		
<i>Lende e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	13,482,562	18,310,253
<i>Prodhime ne proces dhe gjysemprodukte</i>	0	0
<i>Mallra</i>	0	0
<i>Parapagime per inventar</i>	2,248,334	0
Shpenzime te shtyra	2,923,072	147,276
Te arketueshme nga te ardhura te konstatuara	0	0
Totali i aktiveve afatshkurtra	348,587,382	169,010,887
Aktive afatgjate		
Aktive financiare		
<i>Tituj pronesie te njesive ekonomike brenda grupit *</i>	0	0
Aktive materiale		
<i>Toka dhe ndertesa</i>	0	0
<i>Mjete transporti</i>	12,715,487	9,882,564
<i>Te tjera instalime dhe pajisje</i>	2,437,978	2,396,954
<i>Pajisje te tjera</i>	1,689,223	971,803
Aktivitet biologjike	0	0
Aktive jo materiale		
<i>Emri i mire</i>	0	0
Aktivitet tatimore te shtyra	0	0
Totali i aktiveve afatgjate	16,842,688	13,251,321
TOTALI I AKTIVEVE	365,430,070	182,262,208

Administratori



Gjergji Beza

Pasqyra e Pozicionit Financiar DETYRIMET DHE KAPITALI	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
Detyrime afatshkurtra		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	58,896,517	8,233,408
<i>Te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit</i>	188,459,526	72,191,827
<i>Te pagueshme ndaj punonjesve dhe sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	26,715,682	25,590,461
<i>Te pagueshme per detyrime tatimore</i>	2,165,761	118,682
<i>Te tjera te pagueshme</i>	32,409,093	33,813,093
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione	0	0
Totali i detyrimeve afatshkurtra	308,646,579	139,947,471
Detyrime afatgjata		
<i>Detyrime ndaj institucioneve te kredise</i>	7,470,220	16,034,010
Te pagueshme per shpenzime te konstatuara	0	0
Te ardhura te shtyra	0	0
Provizione	0	0
<i>Provizione per pensione</i>	0	0
Detyrime tatimore te shtyra	0	0
Totali i detyrimeve afatgjata	7,470,220	16,034,010
Detyrime totale	316,116,799	155,981,481
Kapitali dhe Rezervat		
Kapitali i nenshkruar	1,470,000	1,470,000
Primi i lidhur me kapitalin	0	0
Rezerva rivleresimi	0	0
Rezerva te tjera		
<i>Rezerva ligjore</i>	0	0
<i>Rezerva te tjera</i>	24,810,727	6,437,561
Fitimi/(humbja) e pashperndare	0	0
Fitimi/(humbja) e periudhes	23,032,544	18,373,166
Totali i kapitalit qe i takon pronareve njesise ekonomike	49,313,271	26,280,727
Interesa jo-kontrollues		
Totali i kapitalit	49,313,271	26,280,727
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALIT	365,430,070	182,262,208

Administratori



Gjergji Bezati

Pasqyra e Performances (<i>sipas natyres</i>)	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhese
Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit		
<i>Te ardhurat nga aktiviteti kryesor</i>	464,752,430	184,062,125
<i>Te ardhurat nga aktiviteti dytesor I</i>	150,973,023	52,136,180
<i>Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit</i>	2,664,000	4,805,296
Te ardhura nga ndryshimi ne inventarin e mallrave dhe prodhimit ne proces	0	0
Te ardhura nga puna e kryer nga njesia ekonomike per qellimet e veta dhe e kapitalizuar	0	0
Te ardhura te tjera te shfrytezimit	0	0
Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme		
<i>Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme</i>	-261,467,972	-57,453,984
<i>Te tjera shpenzime</i>	-44,618,691	-22,764,328
Shpenzime te personelit		
<i>Paga dhe shperblime</i>	-22,162,529	-17,534,608
<i>Shpenzime te sigurimeve shoqerore/shendetsore</i>	-3,722,407	-2,901,073
Zhvleresimi i aktiveve afatgjata materiale		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	-3,301,739	-2,945,862
Shpenzime te tjera shfrytezimi	-257,635,936	-115,054,089
Te ardhura te tjera		
<i>Te ardhura nga njesite ekonomike brenda grupit*</i>	0	0
Zhvleresim i aktiveve financiare dhe investimeve financiare te mbajtura si aktive afatshkurtra	0	0
Shpenzime financiare		
<i>Shpenzime interesi dhe shpenzime te ngjashme</i>	-1,443,360	-482,943
<i>Shpenzime te tjera financiare</i>	-515,473	-193,380
Pjesa e fitimit/(humbjes) financiare nga pjesmarrjet	0	0
Te tjera (te ardhura nga vendimet gjyqesore)	4,030,175	0
Fitimi/(humbja) para tatimit	27,551,521	21,673,334
Tatimi mbi fitimin		
<i>Tatimi mbi fitimin e periudhes</i>	-4,518,977	-3,300,168
Fitimi/(Humbja) e periudhes/vitit (A)	23,032,544	18,373,166

Te ardhura te tjera gjithepershiresore per periudhen/vitin:

Te tjera (pershkruaj)

Totali i te ardhurave te tjera gjithepershiresore per periudhen/vitin (B)	0	0
Totali i te ardhurave gjithepershiresore per periudhen/vitin (A+B)	23,032,544	18,373,166

Administratori



Gjergji Bezati

Pasqyra e fluksit te mjeteve monetare (metoda indirekte)	Periudha Raportuese	Periudha Para ardhese
Fluksi mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit:		
Fitimi/(Humbja) e periudhes	27,551,521	21,673,334
Rregullime per te ardhura dhe shpenzime jo-monetare:		
<i>Shpenzime konsumi dhe amortizimi</i>	3,301,739	2,945,862
<i>Shpenzime te shtyra</i>	-2,775,796	-32,979
<i>Vlera e aktiveve</i>	2,427,697	114,915
Fluksi i mjeteve monetare i perfshire ne aktivite investuese		
<i>Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
Ndryshim ne aktivet dhe detyrimet e shfrytezimit		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	-178,397,317	-29,581,508
Rënie/(rritje) në inventarë	2,579,357	-17,492,909
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	168,699,108	56,603,859
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	0	0
Mjete monetare neto nga/ perdorur ne aktivitetin e shfrytezimit	23,386,309	34,230,574
Tatim fitimi i paguar gjate periudhes	-4,857,109	-3,203,415
Fluksi i mjeteve monetare nga/ perdorur ne aktivitetin e investimit		
<i>Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale</i>	-9,320,803	-987,023
<i>Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale</i>	0	0
<i>Dividentë të arkëtuar</i>	0	0
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e investimit	-9,320,803	-987,023
Fluksi i mjeteve monetare nga/perdorur ne aktivitetin e financimit		
<i>Dividendë të paguar</i>	0	-15,821,460
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme afatgjata	-8,563,790	16,034,010
Mjete monetare neto nga/perdorur ne aktivitetin e financimit	-8,563,790	212,550
Rritje/(renie) neto ne mjetet monetare dhe ekuivalente me to	644,607	30,252,685
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fillim	31,437,978	1,185,293
Efekti i luhatjeve te kurseve te kembimit te mjeteve monetare		
Mjete monetare dhe ekuivalente me to ne fund	32,082,585	31,437,978

Administratori



Gjergji Bezati

Pasqyra e levizjeve ne kapitalin neto	Kapitali i nenshkruar	Rezerva te tjera	Fitim/(humbja) e periudhes	Totali
Pozicioni financiar ne fillim	1,470,000	6,437,561	15,821,460	23,729,021
Efekti i ndryshimeve ne politikat kontabile				0
Pozicioni financiar i rideklaruar ne fillim	1,470,000	6,437,561	15,821,460	23,729,021
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:				0
Fitim/(humbja) e periudhes			18,373,166	18,373,166
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	18,373,166	18,373,166
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:				0
Emetim i kapitalit të nënshkruar	0	0	0	0
Dividende te shperndare				0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)			-15,821,460	15,821,460
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	0	0	-15,821,460	15,821,460
Pozicioni financiar ne fund (viti paraardhes)	1,470,000	6,437,561	18,373,166	26,280,727
Te ardhurat totale gjithëpërfshirëse te periudhes:			23,032,544	23,032,544
Fitim/(humbja) e periudhes				0
Totali i te ardhurave gjithëpërfshirëse per periudhen	0	0	23,032,544	23,032,544
Transaksione per pronaret e njësisë ekonomike te njohura direkt ne kapital:				0
Emetim i kapitalit të nënshkruar				0
Dividende te shperndare				0
Percaktime te tjera per rezultatin e periudhes (pershkruaj)		18,373,166	-18,373,166	0
Totali i transaksioneve per pronaret e njësisë ekonomike	0	18,373,166	-18,373,166	0
Pozicioni financiar ne fund (viti aktual)	1,470,000	24,810,727	23,032,544	49,313,271

Administratori

Gjergji Bezati
Gjergji Bezati



SHENIMET SHPJEGUESE

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria « VIANTE Konstruktion» shpk është krijuar në datë 23.02.2005 me Vendimin Nr. 33037 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me ortak dhe administrator të vetëm Z. Gjergji Bezati. Kapitali i shoqërisë është 1,470,000 leke dhe kuotat e tij zotërohen 100% nga ortaku i vetëm.

Shoqëria ushtron aktivitet në fushën e ndertimit, rikonstrukcione dhe gjatë vitit 2021 ka patur mesatarisht 66 të punësuar (viti 2020 mesatarisht 86 të punësuar.)

Organizimi dhe funksionimi i saj rregullohet sipas ligjit Nr.9901 datë 14/04/2008 “*Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare*” statutit të saj dhe legjislacionit shqiptar në fuqi.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin Nr. 25/2018, datë 10.05.2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 “Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre”, Ministria e financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumë e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël. Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuar të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese

të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020 siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2021 dhe 2020 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2021	2020
Euro/LEK	120.76	123.7
USD/ LEK	106.54	100.84

3.2 Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme. Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën

e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë. Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit.

Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

✓ Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

✓ Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

✓ Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

✓ Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

✓ Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

✓ Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

✓ Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

✓ Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të pasasë të skontuara me normën efektive të interesit. Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor. Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivist me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3 Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetëndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe koston e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në “Ndërtim në proces” dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë. Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e

blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2021 dhe 2020 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyren	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %
Të tjera	Vlera e mbetur	20%

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5 Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundur që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6 Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7 Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9 Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2021 është 15% (2020: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3.10 Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12 Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13 Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

Pasqyra e Pozicionit Financiar AKTIVET

4. Mjete monetare

Mjetet monetare jane ne shumen 32,082,585 leke, te pasqyruara ne tabelen e meposhtme:

Nr	Mjete monetare	Viti 2021	Viti 2020
1	Mjete monetare ne llogari rrjedhese	23,804,564	31,437,978
2	Mjete monetare garanci	7,395,112	-
3	Mjete monetare ne arke	882,909	-
	Totali	<u>32,082,585</u>	<u>31,437,978</u>

Depozitat ne banke ne monedhe te huaj jane te konvertura me kursin e dates 31.12.2021, diferencat nga kursi i kembimit jane te pasqyruara ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

5. Te drejta te arketueshme

Paraqitet shuma e te drejtave te arketueshme deri me 31.12.2021, prej 297,850,829 leke, si me poshte:

Nr	Te drejta te arketueshme	Viti 2021	Viti 2020
1	Klient per shitje e sherbime	297,595,746	114,822,101
2	Tvsh	-	4,274,179
3	Mbipagese ne dogane	13,704	19,100
4	Tatim fitimi I mbipaguar	241,379	-
	Totali	<u>297,850,829</u>	<u>119,115,380</u>

5.1 Klient per shitje e sherbime

Paraqiten kerkesa ndaj klienteve me 31.12.2021 ne shumen 297,595,746 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2021 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

5.2 TVSH

Shoqeria nuk paraqitet me gjendje kreditore tvsh-je me 31.12.2021.

5.3 Mbipagese ne dogane

Paraqitet gjendja e mbipageses ne dogane me 31.12.2021 ne shumen 13,704 leke.

5.4 Tatim Fitimi

Paraqitet gjendja e tatim fitimit te mbipaguar per periudhen deri me 31.12.2021 ne shumen 241,379 leke.

6. Inventarët

Ne kete post paraqitet me 31.12.2021 inventari i materialeve ne shumen 15,730,896 leke, si me poshte:

Nr	Inventaret	Viti 2021	Viti 2020
1	Materiale ndertimi	13,482,562	18,310,253
2	Parapagime per inventar	2,248,334	-
	Totali	<u>15,730,896</u>	<u>18,310,253</u>

Gjendja e materialeve eshte vleresuar me kosto mesatare. Gjate vitit 2021 nuk eshte ndryshuar menyra e mbajtjes se inventarit e cila vazhdon te jete me kosto mesatare.

7. Shpenzime të shtyra

Ne kete post paraqitet me 31.12.2021 shpenzime te cilat i perkasin periudhave te ardhshme ne shumen 2,923,072 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
1	Shpenzime te shtyra	2,923,072	147,276
	Totali	<u>2,923,072</u>	<u>147,276</u>

8. Aktive materiale

Aktivitet afat gjata materiale jane te paraqitura me koston e blerjes minus amortizimin e vitit. Vlera kontabel e tyre eshte 16,842,688 leke, sipas tabelës se meposhtme :

Nr	Emertimi	Mjete Transporti	Makineri e pajisje	Te tjera ne shfrytezim	Totali
I	Aktive afat gjata materiale				
1	Gjendja me 31.12.2020	27,051,146	5,668,919	2,564,750	35,284,815
2	Shtesat per 2021	7,956,108	366,320	998,375	9,320,803
3	Paksimet per 2021	(6,764,560)	-	-	(6,764,560)
4	Gjendja me 31.12.2021	<u>28,242,694</u>	<u>6,035,239</u>	<u>3,563,125</u>	<u>37,841,058</u>
II	Amortizimi I AQT-ve				
1	Gjendja me 31.12.2020	17,168,585	3,271,965	1,592,948	22,033,497
2	Shtesat per 2021	2,695,487	325,296	280,955	3,301,739
3	Paksimet per 2021	(4,336,863)	-	-	(4,336,863)
4	Gjendja me 31.12.2021	<u>15,527,209</u>	<u>3,597,261</u>	<u>1,873,903</u>	<u>20,998,373</u>
III	Vlera neto 31.12.2021	<u>12,715,487</u>	<u>2,437,978</u>	<u>1,689,223</u>	<u>16,842,688</u>

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe shpjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e hyrjes eshte bere me kosto dhe ne daten e mbylljes se bilancit paraqiten me koston e tyre minus zhvleresimin e akumuluar dhe ndonje humbje nga renia e vleres. Drejtimi nuk ka llogaritur renie te vleres per vitin e mbyllur me 31 Dhjetor 2021 dhe 31 Dhjetor 2020.

Pasqyra e Pozicionit Financiar DETYRIMET DHE KAPITALI

9. Detyrime afatshkurtra

Detyrime afatshkurtra te shoqerise me 31.12.2021 paraqiten ne shumen 308,646,579 leke, si me poshte :

Nr	Detyrimet afatshkurtra	Viti 2021	Viti 2020
1	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	58,896,517	8,233,408
2	Detyrime per Furnitore	188,459,526	72,191,827
3	Detyrime per paga ,sigurime shoq, dieta personeli	26,715,682	25,590,461
4	Detyrime tatimore	2,165,761	118,682
5	Divident i paterhequr	32,409,093	33,813,093
	Shuma	<u>308,646,579</u>	<u>139,947,471</u>

9.1 Detyrime ndaj institucioneve te kredise

Paraqitet gjendja e detyrimit afatshkurter ndaj institucioneve te kredise me 31.12.2021 ne shumen 58,896,517 leke, e detajuar si me poshte:

Nr	Detyrime ndaj institucioneve te kredise	Viti 2021	Viti 2020
1	Detyrim kredie Credins Bank	8,563,791	8,147,283
2	Detyrim per interes kredie te maturuar	57,107	86,125
3	Detyrim overdraft Raiffeisen Bank	50,275,619	-
	Shuma	<u>58,896,517</u>	<u>8,233,408</u>

9.2 Detyrime per Furnitore

Paraqitet gjendja e palikujduar e furnitoreve me 31.12.2021 ne shumen 188,459,526 leke. Vlerat e tyre ne monedha te huaja jane konvertuar me kursin e dates 31.12.2021 te Bankes se Shqiperise dhe diferencat jane kontabilizuar ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve sipas SKK-ve.

9.3 Te pagueshme ndaj punonjesve

Paraqitet detyrimi ndaj punonjesve per paga, dieta e sigurime shoqerore te palikujduar deri me 31.12.2021 ne shumen 26,715,682 leke, nga te cilat detyrimi per sigurimet shoqerore e shendetesore dhjetor 2021 eshte ne shumen 506,095 leke.

9.4 Të pagueshme për detyrimet tatimore

Jane te paraqitura detyrimene shumen 2,165,761 leke, me 31.12.2021 sipas tabelës se meposhtme:

Nr	Detyrimet tatimore	Viti 2021	Viti 2020
1	Tatimi mbi te ardhurat personale	52,449	20,723
2	Tatim ne burim	1,206	1,206
3	Detyrim tatim fitimi sipas bilancit	-	96,753
4	Tvsh dhjetor	2,112,106	-
	Shuma	<u>2,165,761</u>	<u>118,682</u>

9.5 Te pagueshme ndaj ortakeve (Divident I paterhequr)

Paraqitet shuma e detyrimit per divident te shperndare nga shoqeria po te palikujduar deri me 31.12.2021 ne vleren 32,409,093 leke. **Theksojme se shoqeria e ka paguar detyrimin per tatimin mbi dividendin sipas afateve ligjore.**

10. Detyrime afatgjata

Detyrimet afatgjata te shoqerise me 31.12.2021 paraqiten ne shumen 7,470,220 leke, dhe perfaqesojne detyrimin per kredine qe ka marre shoqeria prane Credins Bank, si me poshte :

Nr	Detyrimet afatgjata	Viti 2021	Viti 2020
1	Kredia Credins Bank	7,470,220	16,034,010
	Shuma	<u>7,470,220</u>	<u>16,034,010</u>

11. Kapitali

Gjate vitit 2021 jane shtuar kapitalet e veta me fitimin e vitit ne shumen 23,032,544 leke. Shoqeria ka shtuar rezervat e tjera ne shumen 18,373,166 leke, totali i te cilave eshte ne shumen 24,810,727 leke. Totali i kapitaleve te veta te shoqerise me 31.12.2021 eshte 49,313,271 leke.

Nr	Emertimi	Kapitali i nenshkruar	Rezerva te tjera	Fitimi i vitit	Totali
1	Gjendja me 31.12.2020	1,470,000	6,437,561	18,373,166	26,280,727
2	Shtesat per 2021	-	18,373,166	23,032,544	41,405,710
3	Pakesimet per 2021	-	-	(18,373,166)	(18,373,166)
	Gjendja me 31.12.2021	<u>1,470,000</u>	<u>24,810,727</u>	<u>23,032,544</u>	<u>49,313,271</u>

Pasqyra e performances

12. Te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Te ardhurat e realizuara nga aktiviteti i shoqerise per vitin 2021 jane 618,389,453 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Te ardhurat nga aktiviteti i shfrytezimit	Viti 2021	Viti 2020
1	Te ardhura nga aktiviteti	464,752,430	184,062,125
2	Te ardhura nga procesi I rindertimit	150,973,023	52,136,180
3	Te tjera te ardhura nga aktiviteti shfrytezimit	2,664,000	4,805,296
	Totali I te ardhurave	<u>618,389,453</u>	<u>241,003,601</u>

12.1 Te ardhurat nga aktiviteti kryesor

Paraqiten te ardhura nga aktiviteti te realizuara ne vitin 2021 ne shumen 464,752,430 leke

12.2 Te ardhurat nga aktiviteti dytesor I

Shoqeria ka paraqitur te ardhura ne shumen 150,973,023 leke, te cilat perfaqesojne te ardhura nga procesi i rindertimit, te ardhura te deklaruar ne rubriken “Shitje të përjashtuara”, sipas autorizimeve me te cilat eshte pajisur shoqeria jone.

12.3 Te tjera te ardhura nga aktiviteti i shfrytezimit

Paraqiten te ardhura te tjera nga aktiviteti te realizuara ne vitin 2021 ne shumen 2,664,000 leke, te detajuara si me poshte:

Nr	Te tjera te ardhura nga aktiviteti shfrytezimit	Viti 2021	Viti 2020
1	Te ardhura nga shitja e materialeve	-	4,680,296
2	Te ardhura nga shitja e aktiveve	2,664,000	125,000
	Shuma	<u>2,664,000</u>	<u>4,805,296</u>

13. Lenda e pare dhe Materiale te konsumueshme

Shuma e materialeve te konsumuara per vitin 2021 eshte 306,086,663 leke, e cila ne menyre me te detajuar paraqitet si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
1	Materiale te konsumuara	261,467,972	57,453,984
	Shuma I	<u>261,467,972</u>	<u>57,453,984</u>
	Te tjera shpenzime		
1	Karburant	44,568,378	22,635,845
2	Materiale ndihmese	-	17,983
3	Kancelari	50,313	110,500
	Shuma II	<u>44,618,691</u>	<u>22,764,328</u>
	Shuma I+II	<u>306,086,663</u>	<u>80,218,311</u>

14. Shpenzime te personelit

Shpenzimet per personelin, paga dhe sigurime shoqerore e shendetesore per vitin 2021 jane shumen 25,884,936 leke, si me poshte:

Nr	Kosto e Punes	Viti 2021	Viti 2020
1	Shpenzime per paga	22,162,529	17,534,608
2	Sigurime shoqerore dhe shendetesore	3,722,407	2,901,073
	Shuma	<u>25,884,936</u>	<u>20,435,681</u>

Permbledhesja e pagave per vitin 2021, paraqitet si me poshte:

Muaji	Nr	Paga Totale Bruto	Paga mbi te cilen llog. kontributet	Kontribut per sig. shoq. e shend. Punedhenesi	Kontribut per sig. shoq. e shend Punemarresi	Tatimi ne leke	Paga neto
Janar	91	2,414,377	2,414,377	402,883	270,367	22,271	2,121,739
Shkurt	77	2,230,960	2,230,960	372,249	249,832	22,271	1,958,857
Mars	75	2,178,893	2,178,893	363,554	244,001	22,271	1,912,621
Prill	79	2,030,821	2,047,785	341,660	229,314	20,971	1,780,536
Maj	69	1,995,948	2,012,623	335,786	225,378	20,670	1,749,900
Qershor	73	2,133,634	2,150,309	358,780	240,798	20,670	1,872,167
Korrik	73	2,108,735	2,125,410	354,623	238,010	21,060	1,849,665
Gusht	71	1,309,010	1,325,685	221,080	148,444	21,415	1,139,152
Shtator	43	1,296,470	1,313,145	218,973	147,036	23,010	1,126,424
Tetor	42	1,264,111	1,280,786	213,570	143,412	23,010	1,097,689
Nentor	50	1,400,995	1,417,670	236,429	158,741	23,010	1,219,245
Dhjetor	52	1,798,575	1,815,250	302,822	203,273	52,449	1,542,853
Shuma		<u>22,162,529</u>	<u>22,312,893</u>	<u>3,722,407</u>	<u>2,498,605</u>	<u>293,078</u>	<u>19,370,847</u>

15. Shpenzime Konsumi dhe Amortizimi

Jane llogaritur shpenzimet per amortizimin e aseteve sipas normave ligjore ne fuqi per 3,301,739 leke, si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
1	Amortizimi I aktiveve	3,301,739	2,945,862
	Shuma	<u>3,301,739</u>	<u>2,945,862</u>

16. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Ne kete ze jane perfshire shpebzime te tjera shfrytezimi ne shumen 257,635,936 leke, te cilat i perkasin vitit ushtrimor 2021, te detajuara si ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
1	Shpenzime telefonike	225,712	222,023
2	Sherbim kontabiliteti, auditimi, avokatie etj	1,628,925	750,803
3	Sigurime mjetesh, taksa	253,102	164,828
4	Konsum personal	88,458	134,406
5	Certifikim personeli	91,350	81,000
6	Sigurim kontrate	300,216	195,734
7	Transport per blerje	-	111,000
8	Qera	60,000	60,000
9	Qera automjeti	-	90,000
10	Punime nga nenkontraktore	244,948,631	100,872,193
11	Veshje pune dhe Materiale ndihmese	1,154,115	1,041,237
12	Sherbime bankare	242,700	239,270
13	Taksa Lokale	-	123,000
14	Dieta per personelin	2,340,000	8,748,000
15	Konsulence, hartim preventivi	256,672	274,035
16	Riparime mjetesh	1,436,879	1,729,958
17	Te tjera	79,697	88,127
18	Sherbim parkim autoveture	7,720	13,560
19	Vlera kontabel e asetëve te shitura	2,427,697	114,915
20	Mirembajtje rrjeti, konsulence web	257,187	-
21	Bileta udhetimi	1,836,875	-
	Shuma	<u>257,635,936</u>	<u>115,054,089</u>

Kuadrimi I blerjeve me shpenzimet e paraqitura ne bilanc

Ne tabelen e meposhtme paraqitet kuadrimi i blerjeve te pasqyruara ne FDP mujore me shpenzimet e perfshira ne pasqyrat financiare per vitin 2021.

Nr	Sipas FDP	Shuma ne leke
1	Blerje te perjashtuara	90,146,805
2	Blerje investimi brenda vendit pa tvsh	4,819,875
3	Blerje nga furnitore vendas	421,193,064
4	Blerje investimi brenda vendit 20%	4,500,928
5	Import mallra të përjashtuara nga TVSH	48,420,072
6	Import mallra me shkallë tatimore 20%	-
	Totali I blerjeve	<u>569,080,744</u>

Nr	Sipas bilancit	
1	Lenda e pare dhe materiale te konsumueshme	261,467,972
2	Të tjera shpenzime	44,618,691
3	Shpenzime të tjera shfrytëzimi	257,635,936
4	Blerje AQT	9,320,803
	Shuma	<u>573,043,402</u>
Nr	Diferenca	<u>(3,962,658)</u>
1	Ndryshim I gjendjes se inventarit te materialeve	4,827,691
2	Sherbime bankare	242,700
3	Kurs kembimi per parapagimet	(39,256)
4	Rimarrje shpenzime per tu shpendare	147,276
5	Kalim shpenzime per tu shpendare	(2,923,072)
6	Dieta personeli	2,340,000
7	Vlera kontabel e aktive te shitura	2,427,697
8	Parapagime per inventar	(2,248,334)
9	Korigjohet per referencen e importeve	(812,044)
	Diference FDP-Bilanc	<u><u>0</u></u>

17. Shpenzime financiare

Paraqiten shpenzime financiare te shoqerise per vitin 2021 ne shumen 1,958,833 leke te detajuara si ne tabelen me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
1	Humbje nga kursi i kembimit	148,249	189,398
2	Interesa Kredia Credins Bank	994,757	293,545
3	Interesa Overdrafti Raiffeisen Bank	300,354	-
4	Humbje nga mosarketim klienti	-	12,724
5	Shpenzime per gjoba e penalitete	375,401	5,668
6	Shpenzime me fatura jo te rregullta	128,072	66,273
7	Tarife per ankimimi per tender	12,000	108,716
	Shuma	<u>1,958,833</u>	<u>676,323</u>

18. Te tjera (te ardhura nga vendimet gjyqesore)

Paraqiten te ardhura te shoqerise per vitin 2021 nga fitimet e proceseve gjyqesore, ne shumen 4,030,175 leke te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
1	Te ardhura nga vendimet gjyqesore	4,030,175	-
	Shuma	<u>4,030,175</u>	<u>-</u>

19. Llogaritja e rezultatit tatimor

Shoqeria per vitin ushtrimor 2021 paraqitet me nje fitim neto prej 23,032,544 leke. Llogaritja e rezultatit tatimor jepet e permbledhur ne tabelen e meposhtme:

Nr	Emertimi	Viti 2021	Viti 2020
1	Te ardhura nga aktiviteti	618,389,453	241,003,601
2	Shpenzime	(590,837,932)	(219,330,267)
3	Rezultati I ushtrimit	<u>27,551,521</u>	<u>21,673,334</u>
4	Shpenzime te pazbritshme	<u>2,574,990</u>	<u>327,786</u>
5	Fitimi I tatueshem	30,126,511	22,001,120
6	Tatimi I fitimit	4,518,977	3,300,168
7	Fitimi neto i periudhes	<u>23,032,544</u>	<u>18,373,166</u>

Shpenzimet e pazbritshme ne shumen 2,574,990 leke, per vitin 2021 jane te detajuara si me poshte:

Nr	Emertimi	Viti 2020	Viti 2020
1	Gjoha e penalitete	375,401	5,668
2	Shpenzime pa fature	128,072	66,273
3	Shpenzime konsum personal	88,458	134,406
4	Shpenzime ankimimi per tender	12,000	108,716
5	Humbje nga mosarketim klienti	-	12,724
6	Bileta udhetimi	1,836,875	-
7	Komision disbursimi overdrafti	134,184	-
	Shuma	<u>2,574,990</u>	<u>327,786</u>

20. Transaksionet me palet e lidhura

Shoqëria nuk ka transaksione me pale te lidhura gjate vitit 2021.

21. Angazhime dhe pasiguri

Çeshtje gjyqesore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 Dhjetor 2021 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqesore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, qe mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

22. Ngjarje pas datës së Bilancit

Ngjarje pas dates se bilancit eshte situata e krijuar gjate periudhes se fatkeqesise natyrore, e shpallur si pasoje e COVID-19.

Administratori



Gjergji Bezat